


REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE



ZGJEDHJE PRESIDENCIALE 2014

DORACAK PËR EDUKIMIN E ANËTARËVE
TË KËSHILLAVE ZGJEDHOR



MESAZHI I KOMISIONIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Të nderuar anëtar të këshillave zgjedhorë,

Vetëm zgjedhjet të cilat kanë kredibilitet dhe i respektojnë parimet e demokracisë dhe qeverisjes së mirë kontribuojnë në zhvillimin demokratik të shoqërisë. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, me zbatimin e suksesshëm të zgjedhjeve vendos fundamentin e demokracisë dhe kontribuon në zhvillimin dhe mirëbesimin e sistemit zgjedhor në Republikën e Maqedonisë. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, në mënyre kontinuale përpiket të shfaq shembull dhe të mbajë reputacion si organ zgjedhor i pavarur, i paanshëm dhe me përgjegjësi.

Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, në çdo rast është i përgatitur që të realizoj zgjedhje të cilat janë në përputhje me normat demokratike ndërkombëtare, gjatë asaj i përcaktuar për ndjekjen e principit të ciklit zgjedhor. Një nga harqet më kryesore në zinxhirin e realizimit të atyre qëllimeve është edhe këshilli zgjedhor. Si anëtar të tyre pikërisht jeni ju ata të cilët mbani pjesë të barrës, përgjegjësisë por edhe meritat dhe nderin për realizim të suksesshëm të zgjedhjeve. Në ditën e zgjedhjeve, pritjet nga Ju janë të larta, por mirënjohja për realizimin e tyre është akoma edhe më e lartë.

Pjesëmarrja e përbashkët në procesin e bartjes së nivelit të lartë të demokracisë, është vlefshmëri e paçmuar.

Edhe një herë do ta verifikojmë dhe do ta përforcojmë rolin tonë në shoqërinë demokratike të Republikës së Maqedonisë, duke siguruar kushte të barabarta të zgjedhjeve për gjithë pjesëmarrësit dhe liri dhe fshehtësi njëjtë të votës për secilin zgjedhës.

KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

KRYETAR

Nikola Rilkoski



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	5
I. NJË DITË PARA ZGJEDHJEVE.....	6
I.1. MBLEDHJA E KËSHILLIT ZGJEDHOR NJË DITË PARA ZGJEDHJEVE.....	6
I.1.1. DETYRAT E KRYETARIT TË KËSHILLIT ZGJEDHOR.....	7
I.2. PRANIMI DHE SIGURIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR.....	9
I.3. RREGULLIMI I VENDVOTIMIT.....	12
I.4. ZGJEDHËSIT TË CILËT VOTOJNË NJË DITË PARA ZGJEDHJEVE.....	14
I.4.1. VOTIMI I PERSONAVE TË PAFUQISHËM OSE TË SËMURË DHE PERSONAVE NË BURG SHTËPIAK.....	14
I.5. PARA SE TA LËSHONI VENDVOTIMIN.....	17
I.5.1. VOTIMI I PERSONAVE TË CILËT GJENDEN NË VUAJTJE TË DËNIMIT ME BURG OSE JANË PARABURGIM, DHE PERSONAVE TË ZHVENDOSUR BRENDA VENDIT.....	17
II. DITA E VOTIMIT.....	20
II.1. PËRGATITJET PARA FILLIMIT TË VOTIMIT.....	20
II.2. PERSONAT TË CILËT MUND TË JENË TË PRANISHËM NË VENDVOTIM.....	21
II.3. VOTIMI.....	23
II.3.1. PROCEDURA E VOTIMIT.....	24
II.3.2. KUNDËRSHTIMET PREJ VOTUESVE.....	31
II.3.3. VOTIMI I ZGJEDHËSVE TË CILËVE JU DUHET NDIHMË.....	31
II.3.4. MBYLLJA E VENDVOTIMIT.....	32
II.3.5. NDËRPRERJA E VOTIMIT.....	33
II.4. SUMIMI DHE VERIFIKIMI I REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE TË VENDVOTIMIT.....	33
II.5. PAKETIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR.....	38
III. NDALESAT NË VENDVOTIM.....	41
III.1. NDALIMI I PËDORIMIT TË TELEFONIT CELULAR DHE FOTOAPARATIT PËR FOTOGRAFIMIN E FLETVOTIMIT.....	41
III.2. NDALIM PËR MBAJTJEN E ARMËS NË VENDVOTIM.....	41
III.3. NDALIMI I VOTIMIT FAMILJAR, GRUPOR DHE NË EMËR TË TJETRIT.....	42
III.4. BASHKËPUNIMI ME POLICINË NË DITËN E ZGJEDHJEVE.....	43



HYRJE

Këshilli zgjedhor drejtpërsëdrejti zgjedhjet i zbaton në vendvotim dhe është përgjegjës për zbatimin e ligjshëm të tyre.

Ju, si anëtarë të Këshillit zgjedhor, jeni përfaqësues të administratës zgjedhore, ku zgjedhësit gjatë kohës së votimit do të kenë kontakte të drejtpërdrejta me Ju. Ju, jeni pasqyrë në sytë e opinionit vendor dhe atij ndërkombëtarë. Prej punës Tuaj, njohjes dhe zbatimit permanent të rregullave dhe procedurave të përshkruara varet validiteti i procesit zgjedhor dhe vlerësimi i zbatimit të standardeve ndërkombëtare të zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë.

Për këtë arsye është shumë me rëndësi që Ju, gjatë kohës së zbatimit të zgjedhjeve të shfaqni nivel sa më të lartë të profesionalizmit dhe integritetit në punën Tuaj. Kjo u përket obligimeve të Juaja një ditë para zgjedhjeve (shembull: pjesëmarrja e trajnimit të detyrueshëm të Komisionit komunal të zgjedhjeve) si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e organizimit në ditën e zgjedhjeve, zbatimin dhe sumimin e rezultateve pas përfundimit të votimit.

Angazhimi i Juaj duhet të sigurojë fshehtësinë e votës të secilit zgjedhës si dhe integritetin, transparencën, sigurimin dhe zhvillimin e qetë të procesit zgjedhor, me një fjalë Ju me sjelljen Tuaj duhet të kontribuoni në arritjen e lartë në mirëbesimin e procesit zgjedhor.

Detyra e Juaj është që ti zbatoni në tërësi procedurat zgjedhore. Për t'i zbatuar këto procedura duhet rrjedhshëm t'i njihni dhe t'i përcillni procedurat e përshkruara në Kodin zgjedhor dhe udhëzimet e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve. Për këtë qëllim edhe është përgatitur ky doracak. Nëse nuk i zbatoni procedurat e përshkruara Ju e shkelni drejtën e zgjedhësve, shkelni integritetin e procesit zgjedhor, cenoni parimet themelore të demokracisë. Gjithashtu, mosrespektimi i procedurave parasheh edhe sanksione përkatëse, duke filluar me masat e mënjanimit nga organet zgjedhore, dënim me të holla dhe dënim me burg për vepër më të rëndë kundër zgjedhjeve.



I. NJË DITË PARA ZGJEDHJEVE

Këshilli zgjedhor një ditë para zgjedhjeve ndërmerr disa aktivitete.

Qëllimi i këtij kapitulli është posaçërisht për këto veprime(aktivitete) :

1. Përgatitja e Këshillit zgjedhor për mbledhjen,
2. Mbledhja e Këshillit zgjedhor,
3. Ndarja e detyrave(roleve) për ditën e zgjedhjeve,
4. Pranimi dhe sigurimi i materialit zgjedhor,
5. Rregullimi i vendvotimit dhe
6. Zbatimi i votimit për votuesit të cilët janë të sëmurë ose të pafuqishëm ose janë në burg shtëpiak

I.1. MBLEDHJA E KËSHILLIT ZGJEDHOR NJË DITË PARA ZGJEDHJEVE

- Komisioni komunal i zgjedhjeve, e njofton kryetarin e këshillit zgjedhor për kohën e pranimi të materialit zgjedhor.
- Kryetari i këshillit zgjedhor, e njofton zëvendëskryetarin dhe anëtarët për kohën e pranimi të materialit zgjedhor dhe thërret këshillin zgjedhor një orë para pranimi të materialit zgjedhor të mblidhen para vendvotimit
- Rekomandohet që këshilli zgjedhor të jetë në përbërje të tërësishme!

Kryetari dhe anëtarët tjerë të këshillit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve konsultohen PËR NDARJEN E DETYRAVE(ROLEVE). Rolet e anëtarëve të këshillit zgjedhor janë:

- Personi i cili kujdeset për rendin e hyrjes në lokalin ku votohet dhe i kontrollon votuesit se a kanë njollë prej ngjyrës së dukshme për markim në gishtin e madh të dorës së djathtë (1)
- Personi i cili i kontrollon dokumentet e identifikimit personal (2)
- Personi i cili shërben me ekstraktin e listës zgjedhore (3)
- Personi i cili i ndanë fletëvotimet dhe i vulosë (4)
- Personi i cili shërben me markerin për markimin e votuesve – ngjyre të tejdukshme për markim dhe i cili kujdeset që fletëvotimet të vihen në kuti të votimit (5)

Secili anëtar i këshillit zgjedhor, përveç detyrës themelore, kryen edhe punë të tjera të cilat janë të domosdoshme për organizimin e pandërprerë në zbatimin e zgjedhjeve.

Kryetari, zëvendëskryetari, anëtarët dhe zëvendësanëtarët e Këshillit Zgjedhor janë të detyruar që të nënshkruaj DEKLARATË PËR SIGURIMIM E FSHEHTËSISË DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Formularin e kësaj deklarate e marrin prej komisionit komunal të zgjedhjeve dhe pas nënshkrimit i kthehet të njëjtit.



I.1.1. DETYRAT E KRYETARIT TË KËSHILLIT ZGJEDHOR

Para fillimit të votimit

- Plotëson Procesverbalin (Formulari numër 15) për verifikimin e gjendjes së lokalit, materialit zgjedhor dhe kutitë e votimit
- Plotëson pjesën e Procesverbalit për votim, sumim dhe konfirmim të rezultateve (Formulari numër 16a), e cila plotësohet para fillimit të votimit.
- Anëtarëve të këshillit zgjedhor iu shpërndan materialin zgjedhor (i besueshëm dhe jo i besueshëm).
- E shënon numrin e vendvotimit në zarfe, në thasë dhe materiale tjera që do të përdoren në ditën e zgjedhjeve.
- Kujdeset (organizon) që vendvotimi të jetë i rregulluar në mënyrë përkatëse.
- Kutitë e zbrazëta iu tregojnë të gjithëve të cilët janë të pranishëm në vendvotim.
- Nëse këshilli zgjedhor, një ditë më parë ka zbatuar votimin e persona të sëmurë ose të pa fuqishëm apo persona të cilët janë në burg shtëpiak, para se ta mbyll kutinë duhet:
 - I HAP zarfet e mbyllura me fletëvotimet të këtyre zgjedhësve,
 - Pa marrë parasysh për cilën është votuar i lëshon në kutinë e votimit.
 - Numrin e këtyre fletëvotimeve e shënon në Procesverbalin numër
- Mbyll kutinë e votimit të numëruar me shirit siguries plastik dhe të njëjtën e vendosë në vend të dukshëm që mund ta shohin gjithë personat e autorizuar që janë të pranishëm në vendvotim. Numrat e shirit siguries plastik të numëruar i shënon në Ditarin për evidencë të ngjarjeve.

Gjatë kohës së votimit

- Kujdeset për gjitha aktivitetet që do të zbatohen në vendvotim në pajtim me procedurat e përmbajtura në Doracakun e edukimit.
- Në procesverbal dhe në Ditarin e ngjarjeve e shënon kohën e hapjes së vendvotimit (Formulari numër 16a)
- I plotëson procesverbalet (tërësisht dhe në mënyrë të drejtë)
- Në Komisionin komunal të zgjedhjeve i dorëzon të dhënat e daljes së votuesve.
- Është përgjegjës për mbajtjen e rendit dhe qetësisë në vendvotim. Në rast të prishjes së rendit ai:
 - thërret policinë (me gojë, me shkrim, telefon ose në mënyrë tjetër)
 - plotëson Formularin në lidhje me thirrjen e policisë dhe
 - menjëherë e njofton Komisionin komunal të zgjedhjeve.
- Kur rendi dhe qetësia rivendosen kujdeset që policia duhet ta lëshojë vendvotimin
- Evidenton në procesverbal (formulari 16a) dhe në Ditarin e evidencës së ngjarjeve votimin e zgjedhësve të cilëve ju duhet ndihma.
- Komunikon me përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listës, vëzhguesit dhe gazetarët, mirëpo vetëm për INFORMACIONE TEKNIKE RRETH PROCESIT ZGJEDHOR (shembull, numri i zgjedhësve të regjistruar në ekstraktin e listës zgjedhore, të dhënat për daljen e votuesve deri në momentin e dhënies së deklaratës etj.)

Për informacionet tjera në lidhje me ecurinë e zgjedhjeve dhe procesin zgjedhor, gazetarët i drejtojnë në KSHZ.



Gjatë kohës së mbylljes së vendvotimit

- Vendvotimi mbyllet në ora 19:00,
 - Nëse ka votues të cilët presin në radhë për të votuar, do të caktojë një nga anëtarët e këshillit zgjedhor që të qëndrojë në fund të rendit të votuesve të cilët janë hasur para objektit të votimit.
- Do ta mbyll kutinë e votimit
- Do të vërtetohet se pas votimit të votuesit të fundit, në vendvotim janë të pranishëm vetëm personat e autorizuar
- Kohën e mbylljes së vendvotimit e shënon në Procesverbal (Formulari 16a)
- Në ditarin për evidencë të ngjarjeve:
 - shënon kohën e mbylljes së vendvotimit
 - shënon emrat e pranishëm të përfaqësuesve të autorizuar dhe vëzhguesve

Gjatë numërimit të votave

- Duke numëruar nënshkrimet dhe gjurmët në listën zgjedhore, verifikohet numri i përgjithshëm i zgjedhësve të cilët kanë votuar. Ky numër shënohet edhe në procesverbalin (Formularin numër 16a).
- Pyet përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesit të listës se a kanë vërejtje për procedurën e votimit, nëse kanë, vërejtjet e tyre i shënon në procesverbal (Formulari numër 16a), në pjesën për vërejtje të procedurës së votimit.
- Kujdeset për respektimin e procedurave të cekura për sumimin dhe verifikimin e rezultateve.
- në procesverbal (Formulari numër 16a), i regjistron të dhënat të cilat verifikohen në procedurën e barazimit të fletëvotimeve
- kontrollon a përputhet numri i shiritave sigurues plastik të numëruar me të cilat mbyllet kutia e votimit me numrat e shënuara më parë në Ditarin për evidencë të ngjarjeve.
 - Nëse numrat përputhen, këtë e shënon në Ditar.
 - Nëse nuk përputhen, këtë rast e shënon në Procesverbal (Formulari numër 16a) në pjesën e vërejtjeve për procedurën e votimit dhe në ditarin për evidencën e ngjarjeve dhe për këtë e njofton Komisionin komunal të zgjedhjeve, DHE VAZHDON ME PROCEDURËN E NUMËRIMIT TË VOTAVE.
- HAP kutinë e votimit.
- (Me short përcaktohet cili nga anëtarët e këshillit zgjedhor do ti nxjerrë fletëvotimet prej kutisë së votimit, i hapë dhe ja jep kryetarit.)
- kryetari i KZ-së secilën fletë të votimit ua tregon të pranishmëve.

Gjatë kohës së paketimit të materialit zgjedhor

Kujdeset për vendosjen e materialit të tërësishëm zgjedhor në thasë përkatëse. Ndjek teknikën e paketimit siç është përshkruar në pjesën e këtij doracaku „Paketimi i materialit zgjedhor” (shiko në faqe 37)



I.2. PRANIMI DHE SIGURIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR

- Komisioni komunal i zgjedhjeve, këshillin zgjedhor e njofton për kohën e saktë të pranimi të materialit zgjedhor
- Për pranimin e materialit zgjedhor përpilohet procesverbal.(Formulari numër14a).
- Në pranimin e materialit zgjedhor është e detyrueshme që të jenë kryetari dhe së paku dy anëtarë të KZ-së

Anëtarët e Këshillit Zgjedhor, menjëherë pas pranimi të materialit zgjedhor duhen detajisht të kontrollojnë numrin e fletëvotimeve të pranuar!!!

NË MUNGESË TË KRYETARIT TË KËSHILLIT ZGJEDHOR, TË GJITHA AKTIVITETET E ÇEKURA I ZBATON ZËVENDESKRYETARI

PROCEDURA (FORMULA) E NUMËRIMIT TË FLETËVOTIMEVE TË PRANUARA:

- Fletëvotimet i pranoni me bllokun amë.
- Secili fletëvotim ka numër serik
- Numri serik është i shtypur në pjesën e fletëvotimit e cila mbetet në bllokun amë. (shikoje fotografinë)
- Pranoni një bllok amë për zgjedhje për Kryetar të Republikës së Maqedonisë
- **BLLOKUN AMË KONTROLLOJENI ME KUJDES!**
- Shfrytëzoni numrat serik një nga një për të kontrolluar sa fletëvotime keni pranuar në bllokun amë.
- Nga numri serik i fletëvotimit të fundit merret numri serik i fletëvotimit të parë dhe rritet për +1 sipas formulës në vijim:

SHEMBULL:

Numri serik i fletëvotimit të fundit	-	Numri serik i fletëvotimit të parë	+ 1 =	Numri i përgjithshëm i fletëvotimeve
2.035	-	1.501	+ 1 =	535

- Numri i fletëvotimeve duhet të jetë i njëjtë me numrin e zgjedhësve të regjistruar në Ekstraktin e listës zgjedhore.

Shembull: Nëse në listën zgjedhore janë të regjistruar 535 zgjedhës duhet të pranoni 535 fletëvotime





Në pranimin e materialit zgjedhor mund të jenë të pranishëm:

1. përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave (ata kanë të drejtë të parashtrojnë vërejtje, dhe vërejtjet e tyre të evidentohen në procesverbal (Formulari numër 14a)
 2. vëzhguesit e akredituar
 3. gazetarët
- Përfaqësuesit e policisë, e sigurojnë pranimin e materialit zgjedhor, vendvotimin, këshillin zgjedhor dhe gjithë personat që janë të pranishëm në pranimin e materialit zgjedhor
 - Pas përfundimit të pranimin të materialit zgjedhor, objekti mbyllet deri në ditën e zgjedhjeve

LLOJET E MATERIALIT ZGJEDHOR

MATERIALI ZGJEDHOR I BESUESHËM	MATERIALI ZGJEDHOR JO I BESUESHËM
1. Bllok amë me fletëvotime 2. ekstrakti i Listës zgjedhore për vendvotimin 3. ditar i evidencës së ngjarjeve për vendvotimin; 4. Marker-ngjyrë e dukshme për markim të votuesve 5. vulë me numrin e vendvotimit 6. formularë dhe procesverbal të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve: • Procesverbal për verifikimin e gjendjes së lokalit për zgjedhje materialit zgjedhor dhe kutive të votimit nga këshilli zgjedhor (Formulari numër 15) • Procesverbal për votim, sumim dhe verifikim i rezultateve të vendvotimit (Formulari numër 16 a) • Procesverbal për dorëzimin e materialit zgjedhor të Komisionit komunal të zgjedhjeve (Formulari numër 20 a) • Procesverbal për verifikimin e nevojës për thirrjen e policisë	7. paravan zgjedhore; 8. Lista të kandidatëve (pano informuese); 9. kuti votimi; 10. shirit sigurues plastik për mbylljen e kutisë së votimit dhe thes për transportin e materialit zgjedhor të besueshëm 11. zarfe për paketim, nga një: • fletëvotimet të përdorura (të vlefshme dhe të pavlefshme) • fletëvotime të papërdorura • bllokun amë, lista zgjedhore dhe Ditari për evidencë të ngjarjeve; • një zarf mbrojtjes rezervë; 12. thasë plastiku të mëdhenj, të tejdukshëm të veçuar me etiketë: • një thes për transport të materialit zgjedhor të besueshëm; • një thes për transport të materialit zgjedhor jo të besueshëm; 13. material tjetër jo të besueshëm ku bënë pjesë: • stilolaps; • marker; • vizore; • mbështetës grafiku për markimin e gishtit; • bexhe për anëtarët e këshillit zgjedhor; • doracak për anëtarët e këshillit zgjedhor; • udhëzim për votim dhe • materiale tjera.




2.



3.




4.



9.



10.



VENI RE:

- Për vendvotimet të cilët kanë nën 500 votues, këshillit zgjedhor i jepet një marker-ngjyrë e dukshme për markim të zgjedhësve.
- Për vendvotimet të cilët kanë mbi 500 votues, këshillit zgjedhorë i jepen dy marker-ngjyrë e dukshme për markim të zgjedhësve..

ME RËNDËSI:

- Për ruajtje të markerëve-ngjyrë e dukshme për markim të zgjedhësve, obligohet kryetari i KZ-së
- Pas mbarimit të votimit, KZ-ja deri te KKZ, kthen po aq markerë-ngjyre e dukshme për markim të zgjedhësve, sa ka marrë nga KKZ-ja, pa marrë parasysh se në çfarë gjendje janë ato.



I.3. RREGULLIMI I VENDVOTIMIT

NDALIMI I PROPAGANDËS:

- Mënjanoni gjithë materialet propaganduese (panotë, pamfletet, etj).
 - në lokal ku është i vendosur vendvotimi.
 - jashtë në radius prej 100 metrash larg vendvotimit.

INFORMIMI I VOTUESVE:

Materialet informative për gjithë votuesit, që të munden sa më lehtë të orientohen në objekt të ngjiten në vend të dukshëm:

- Shenjën me numrin e vendvotimit ku do të votohet ngjiteni në hyrje të objektit (nëse në objekt gjenden dy ose më shumë vendvotime, numri rendor i tyre veçon çdo lokal që është i përcaktuar për votim)
- Shfaqni listat e kandidatëve për votuesit në vend të dukshëm
- Shfaqni përshkrimin e vendvotimit (me adresa)
- Udhëzimin për votim: vendoseni në vend, ku votuesve të rinj u mundëson ta vërejnë dhe ta lexojnë sa më mirë
- Veçoni kutinë e votimit me shenjë përkatëse


ORGANIZIMI I VENDVOTIMIT

- Renditni tavolinat ose karriget që mos e pengojnë votimin

PËR PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR DHE VËZHGUESIT, SIGURONI POZICION PREJ KU DO TË KENË DUKSHMËRI TË TËRËSISHME TË PROCESIT ZGJEDHOR.

Për ta është e lejuar:

- prej së afërmi ta verifikojnë identitetin e votuesve
 - pa pengesë ta vëzhgojnë procesin e votimit, mirëpo
 - mos e cenojnë fshehtësinë e votimit, të mos kenë këqyrje në hapësirën pas paravanëve zgjedhore.
- Vendosni paravanët zgjedhore që të sigurohet fshehtësia dhe askush të mos shoh se si votuesi e plotëson fletëvotimin



Vendvotimi i rregulluar



I.4. ZGJEDHËSIT TË CILËT VOTOJNË NJË DITË PARA ZGJEDHJEVE

Ekzistojnë tri grupe të votuesve të cilët votojnë një ditë para zgjedhjeve:

- 1) Persona të pafuqishëm ose të sëmurë, dhe personat në burg shtëpiak,
- 2) Persona të cilët gjenden në vuajtjen e dënimit me burg ose gjenden në paraburgim, dhe
- 3) Persona të zhvendosur brenda vendit.

I.4.1. VOTIMI I PERSONAVE TË PAFUQISHËM OSE TË SËMURË DHE PERSONAVE NË BURG SHTËPIAK

1. CILËT PERSONA MUND TË VOTOJNË NJË DITË PARA ZGJEDHJEVE NË ADRESËN E PARAQITUR?

Komisioni komunal i zgjedhjeve, përgatit Listë të personave të pafuqishëm ose të sëmurë, të cilët do të votojnë në shtëpitë e tyre.

Komisioni komunal i zgjedhjeve këto lista iu dorëzon këshillave zgjedhor.

Vetëm personat që gjenden në listë, mund të votojnë një ditë para ditës së zgjedhjeve!

2. KUSH E ZBATON VOTIMIN E PERSONAVE TË PAFUQISHËM OSE TË SËMURË?

Votimin për këto persona e zbaton Këshill zgjedhor ku personi është i regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore të vendvotimit përkatës.

Votimi zbatohet në adresën të cilën e paraqet votuesi, e cila mund të jetë e ndryshme nga adresa në dokumentin për identifikim personal, por me kusht që e njëjta të jetë në territorin e komunës përkatëse.

3. ÇKA DUHET KËSHILLI ZGJEDHOR TË MERR ME VEHTE PËR ZBATIMIN E VOTIMIT E PERSONAVE TË PAFUQISHËM OSE TË SËMURË?

- 1) ekstrakt të Listës zgjedhore,
- 2) Markerë-ngjyre të dukshme për markim të votuesve
- 3) vulën me numër të vendvotimit,
- 4) fletëvotime për zgjedhjen e kryetarit të Republikës së Maqedonisë (aq sa ka votues në listën e pranuar të komisionit komunal të zgjedhjeve),
- 5) Zarfe të zbrazura (për çdo fletëvotim të shkëputur nga një zarf),
- 6) Një kuti votimi (E MBYLLUR ME SHIRIT SIGURUES!) dhe
- 7) Mbështetës grafiti për gjurmë të gishtërinjve (në rast se ndonjë nga votuesit e sëmurë ose të pafuqishëm është analfabet).

VENI RE: Përpara se këshilli zgjedhorë ti shkëput fletëvotimet, kontrollon se a gjenden në ekstraktin e listës zgjedhore votuesit të cilët janë të evidentuar në listën e përgatitur nga KKZ-ja për atë vendvotim. Më pas Këshilli zgjedhor, i shkëput fletëvotimet nga blloku amë. Me vete merr aq fletëvotime sa votues ka të regjistruar në listë!




4. CILA ËSHTË PROCEDURA E VOTIMIT PËR PERSONA TË PAFUQISHËM OSE TË SËMURË?

- Këshilli Zgjedhor e mbyll kutinë e votimit me shirit plastik të numëruar
- Numrat e shiritave sigurues me të cilët është mbyllur kutia e votimit i shënon në ditar.
- Këshilli zgjedhor shkon në shtëpinë e votuesit.

PERSON TJETËR I SHTËPISË SË VOTUESIT I CILI NUK GJENDET NË LISTËN ZGJEDHORE NUK MUND TË VOTOJË NË SHTËPI!

- Këshilli zgjedhor e ndjek procedurën e votimit nga HAPI 1 DERIN NË HAPIN E 5, si është e përshkruar në faqen 21!
- Këshilli zgjedhor gjatë aktit të votimit, votuesit duhet ti sigurojë fshehtësi të votës.
- Votuesi pas votimit të kryer, fletëvotimin e palos dhe para Këshillit Zgjedhor e vendos në zarf të veçantë (kjo bëhet që Këshilli zgjedhor të sigurohet që fletëvotim është i vendosur në zarf të veçantë).
- Votuesi e mbyll zarfin dhe e lëshon në kuti të votimit të cilën Këshilli Zgjedhor e merr vete.



ME RËNDËSI: Këshilli zgjedhor, gjatë zbatimit të këtij lloji të votimit nuk ka orar të caktuar pune! Këshilli zgjedhor, punon deri sa të gjithë personave të cilët gjenden në listë u mundëson të votojnë!

- Këshilli zgjedhor, pasi përfundon me votimin, kthehet në vendvotim dhe numrat e shiritave sigurues me të cilët është mbyllur kutia e votimit i shënon në ditar.
- Këshilli zgjedhor, pas zbatimi të votimit, kutinë e mbyllur të votimit me zarfet e mbyllura e vendosë në vendvotim.
- KZ e lëshon vendvotimin. Me këtë përfundon puna e këshillit zgjedhor për këtë ditë.

PËR FAQËSUESIT E AUTORIZUAR TË PARASHTRUESVE TË LISTAVE KANË TË DREJTË QË TA NDJEKIN TËRË PROCEDURËN E VOTIMIT TË ZGJEDHËSVE TË KËSAJ KATEGORIE



5. SI TË VEPROJË KËSHILLI ZGJEDHOR NË RASTË SE:

Votuesin i cili është në listën e votimit të personave të pafuqishëm ose të sëmurë NËSE NUK E GJENI në adresën shtëpiake	----->	- Vazhdoni me zbatimin e votimit të tjerëve nga lista. - KZ-ja nuk kthehet në shtëpinë e votuesit.
PERSON TJETËR I SHTËPISË së votuesit i cili është në Listën zgjedhore dhe DËSHIRON TË VOTOJË në shtëpinë e tij	----->	Nëse ky person nuk gjendet në listën e pranuar të Komisionit komunal të zgjedhjeve nuk mundet të votoj në shtëpinë e tij.
Votuesi i cili gjendet në listë NËSE REFUZON TË VOTOJË në shtëpinë e tij.	----->	KZ-ja e lëshon shtëpinë e votuesit. Rastin e shënon në Ditar.
Votuesi i cili ka qenë në listë,ndërsa nuk ka votuar në shtëpinë e tij,NËSE NË DITËN E VOTIMIT vjen në vend votimit dhe dëshiron të votojë.	----->	KZ-ja nuk do t'i lejojë që të votojë.
Votuesi i cili gjendet në listën e pranuar të Komisionit komunal të zgjedhjeve, mirëpo NUK GJENDET NË LISTËN ZGJEDHORE.	----->	KZ-ja nuk do t'i lejojë të votojë. Do ta drejtojë (ose njërin nga anëtarët e familjes së personit të pafuqishëm ose të sëmurë)në Njësinë rajonale të KSHZ-së.

6. ÇKA BËHET ME FLETVOTIMET E PAPËRDORURA?

- Këshilli zgjedhor, në Ditarin e ngjarjeve i thekson shkaqet përse fletëvotimet kanë mbetur të papërdorura.
- Këshilli zgjedhor, këto fletëvotime iu këputë këndin e djathtë të pjesës së poshtme. Këto fletëvotime i ruan në zarf të veçantë.
- Në ditën e votimit gjatë sumimit të rezultateve fletëvotimet e papërdorura numërohen bashkë me fletëvotimet tjera të papërdorura



I.5. PARA SE TA LËSHONI VENDVOTIMIN:

- Edhe një herë kontrolloni vendvotimin se a është i rregulluar që votimi të zbatohet në mënyrë të papenguar.
- Vërtetojuni se secili anëtar i këshillit zgjedhor i kuptuar detyrat e dhëna
- Në fund, para se lëshoni vendvotimin:

Materialin zgjedhor të besueshëm vendoseni në një thes të madh plastiku të tejdukshëm dhe mbylleni me shirit sigurues numerik. Numrin e shiritit numerik e shënoni në Ditar. Në prani të policisë mbyllni derën dhe dritaret.

ME RËNDËSI: Në ato vendvotime ku nuk ka kushte të ruhet materiali zgjedhor, është e detyrueshme që materiali zgjedhor të vendoset në lokalet e Komisionit komunal të zgjedhjeve.

I.5.1. VOTIMI I PERSONAVE TË CILËT GJENDEN NË VUAJTJE TË DËNIMIT ME BURG OSE JANË PARABURGIM, DHE PERSONAVE TË ZHVENDOSUR BRENDË VENDIT

- Personat të cilët në ditën e zgjedhjeve gjenden në vuajtje të dënimit me burg ose janë në paraburgim, votojnë në shtëpitë ndëshkuese-përmirësuese.
- Personat e zhvendosur brenda vendit, janë zgjedhës të zhvendosur brenda vendit të cilët votojnë nëpër qendrat e personave të zhvendosur brenda vendit.
- Këto dy kategori të zgjedhësve votojnë një ditë para ditës së përcaktuar të zgjedhjeve.

Zgjedhjet i zbaton këshilli zgjedhor i vendvotimit më të afërm.

NJOFTOHEN EDHE PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR TË PARASHTRUESVE TË LISTAVE QË TË JANË TË PRANISHËM NË VOTIM.



PROCEDURA E VOTIMIT

- Këshilli Zgjedhor, është i detyruar që në shtëpinë ndëshkuese- përmirësuese dhe në qendrën e personave të zhvendosur brenda vendit të vendosë vendvotim të përkohshëm.
- Vendvotimi hapet në ora 07:00
- Këshilli zgjedhor, ndjekë procedurën e përgjithshme zgjedhore nga HAPI 1 DERI NË HAPIN 6 siç është e përshkruar në faqe 21!


VENI RE: Këshilli zgjedhor, për këtë lloj të votimit pranon ekstrakt të veçantë të Listës zgjedhore!

ME RËNDËSI: Votuesit, bashkë me fletëvotimin i jepet dhe zarf të zbrazur në të cilin shënohet emri i komunës ku votuesi e ka vendbanim.

- Votuesi, pas përfundimit të votimit, palos fletëvotimin dhe e vendosë në zarf të zbrazur të veçantë.
- Votuesi, i tregon Këshillit zgjedhor se secili fletëvotim është i vendosur në zarf të veçantë.
- Votuesi, mbyll secilin zarf dhe lëshon në kuti të votimit.
- Vendvotimi mbyllet në ora 19:00.
- Pas mbarimit të votimit, Këshilli Zgjedhor i prishë fletëvotimet e papërdorura në mënyrë që ua shkëput këndin e poshtëm të djathtë dhe i vizaton gjatë tërë gjatësisë, të njëjtët i vendos në zarf të veçantë ku është e shënuar komuna, si dhe shenjë se për çfarë materiali bëhet fjalë, gjithashtu në zarfe shënohet edhe numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të papërdorura.
- Më pas, këshilli zgjedhorë e hap kutinë e votimit, zarfet i selekton në komuna (pa i hapur) dhe përpilon procesverbal (Formularin numër 18a) për çdo komunë.
- Zarfet e pahapura me fletëvotime të përdorura, zarfet me fletëvotime të papërdorura, Ekstrakti i veçantë të listës zgjedhore dhe procesverbalet, paketohen në një zarf të madhe për secilën komunë në veçanti, dhe në zarf shënohet emri i komisionit komunal përkatës.
- Materialin zgjedhorë kështu të paketuar, Këshilli Zgjedhor ia dorëzon komisionit komunal nga i cili e ka pranuar materialin.

Këshilli Zgjedhor për këtë lloj të votimit përpilon procesverbal të veçantë:

- Procesverbal të veçantë i votimit për Kryetar të Republikës së Maqedonisë për personat të cilët gjenden në vuajtje të dënimit me burg ose janë në paraburgim (Formulari numër 18a).
- Procesverbal të veçantë i votimit për Kryetar të Republikës së Maqedonisë, për personat me status të shpërngulurve brenda vendit (Formulari numër 19a).





II. DITA E VOTIMIT

Angazhimi i secilit anëtar të Këshillit Zgjedhor në ditën e votimit, duhet të sigurojë fshehtësinë e votës të secilit zgjedhës si dhe integritetin, transparencën dhe zhvillimin e qetë të procesit zgjedhor. Këshilli zgjedhor gjithashtu me punën e tij të kontribuojë në ngritjen e nivelit të lartë në mirëbesimin e procesit zgjedhor.

QËLLIMI i këtij kapitulli është që këshillin zgjedhor ta përgatit në mënyrë sa më të drejtë:

- 1) Ta zbatojë procedurën e votimit,
- 2) Numërimin e votave dhe
- 3) Sumimin e rezultateve të votimit.

II.1. PËRGATITJET PARA FILLIMIT TË VOTIMIT

Koha:	Aktivitetet:
Ora 6:00.	• Secili anëtar i Këshillit Zgjedhor arrin në vendvotim
Ora 6:05.	• Nëse ndonjëri nga anëtarët nuk është i pranishëm, kryetari e njofton Komisionin Komunal Të Zgjedhjeve.
Ora 6:10.	• Kryetari i Këshillit Zgjedhor thërret përfaqësuesin e policisë, që të shoqërojë në vendvotim gjatë HAPJES dhe këqyrjes së lokalit zgjedhor
Ora 6:10 – 6:20.	• KZ-ja, kryen këqyrjen e lokalit dhe plotëson Procesverbalin (Formulari nr.15)
Ora 6:20 – 6:30.	• Rregullimin e vendvotimit dhe kutinë e zbrazët
Ora 6:30.	• Kryetari i Këshillit Zgjedhor e tregon kutinë e zbrazur të votimit dhe shiritat sigurues plastik të numëruara. (të pranishëm janë të gjithë anëtarët e KZ-së, përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave të kandidatëve, vëzhguesit dhe gazetarët) • Numrat e shiritave i shënon në Ditar.
Ora 6:35.	• Kryetari, në etiketat ngjitëse shkruan numrin e vendvotimit dhe i ngjet në një nga anët e kutisë së votimit.
Ora 6:35 – 6:50.	• Para se të mbyllet kutia e votimit, nëse këshilli zgjedhor një ditë më parë ka kryer votim në shtëpitë e personave të pafuqishëm ose të sëmurë/personave në burg shtëpiak: - HAPEN zarfet e mbyllura me fletëvotime - fletëvotimet një nga një pa u parë se për cilin është votuar lëshohen në kutinë e votimit - numri i këtyre fletëvotimeve shënohet në Procesverbal (Formulari numër 16a),
Ora 6:50 – 6:55	• Mbyllet kutia e votimit (nga vrimat e anëve të kapakut të kutisë së votimit vihen të dy shiritat sigurues plastik dhe tërhiqen fortë)
Ora 6:55 – 7:00.	• Numri i shiritave sigurues plastik shënohet në Ditarin e evidencës së ngjarjeve

Vendvotimi hapet në ora 07:00. Kohëzgjatja e hapjes së vendvotimit shënohet në Procesverbal (Formulari numër 16a), dhe në Ditarin evidencës së ngjarjeve.



II.2. PERSONAT TË CILËT MUND TË JENË TË PRANISHËM NË VENDVOTIM

• Votuesit	→	• Nuk guxojnë të ndalen më tepër kohës së duhur të votimit
• Anëtarët / zëvendësanëtarët e këshillit zgjedhor	→	• Pesë vetë të cilët e zbatojnë votimin
• Anëtarët/zëvendësanëtarët e Komisionit komunal të zgjedhjeve	→	• Gjatë xhiros së vendvotimeve; mund të ndalen aq sa është e domosdoshme për vëzhgimin e procesit zgjedhor
• Anëtarët e KSHZ-së dhe anëtarët e Shërbimit profesional të KSHZ-së	→	• Gjatë xhiros së vendvotimeve; mund të ndalen aq sa është e domosdoshme për vëzhgimin e procesit zgjedhor
Persona të cilët kanë të drejtë ta vëzhgojnë punën e KZ: 1) Përfaqësues të autorizuar të parashtruesve së listave të kandidatëve * 2) Vëzhgues të akredituar** dhe 3) Gazetarë të akredituar të vendit dhe ndërkombëtarë ***	→ ↗ →	• Gjatë hapjes së vendvotimit, • Gjatë gjithë kohës deri sa zgjat votimi, • Gjatë numërimit të votave dhe sumimit të rezultateve • Deri sa zgjatë votimi

* PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR TË PARASHTRUESËVE SË LISTAVE TË KANDIDATËVE

Përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve së listave të kandidatëve, para këshillit zgjedhor gjatë legjitimit tregojnë:

- Autorizim, cili përmban emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit si dhe numrin e vendvotimit për të cilin është i autorizuar ta vëzhgojë
- Dokument të identifikimit personal

VËREJTJET e përfaqësuesve të autorizuar:

Përfaqësuesit e autorizuar mund të kërkojnë që vërejtjet e tyre të shënohen në Procesverbal. KËSHILLI ZGJEDHOR ËSHTË I DETYRUAR T'I ZBATOJË KËRKESAT!

Përfaqësuesit e autorizuar NUK GUXOJNË:

- të shfrytëzojnë ekstraktin e Listës zgjedhore për kontrollimin e zgjedhësve,
- të mbajnë simbole partiake në vendvotim.



** VËZHguesIT E AKREDITUAR

Vëzhguesit e akredituar (vendor dhe ndërkombëtarë) legjitimohen me:

- BEXH për vëzhgues të lëshuar nga KSHZ-ja, janë të detyruar ta mbajnë me vete.
- Dokumentin e identifikimit personal.

Vëzhguesit, kanë të drejtë të kërkojnë që vërejtjet e tyre të shënohen në Ditarin e evidencës së ngjarjeve në vendvotim.



*** GAZETARËT

GAZETARËT e vendit para këshillit zgjedhor legjitimohen me:

- BEXH të lëshuar nga Komisioni shtetëror i zgjedhjeve
- Akreditim të lëshuar nga shtëpia gazetareske e tyre, ose nga Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë ose Unioni i gazetarëve të Maqedonisë dhe
- Dokument të identifikimit personal.



Gazetarët NDËRKOMBËTARË të akredituar legjitimohen me bexh të lëshuar nga KSHZ-ja.

ME RËNDËSI: PUNA E KËSHILLIT ZGJEDHOR NUK GUXON TË PENGOHET

Nëse ndonjëri nga përfaqësuesit e autorizuar, vëzhgues ose gazetarët, pengon punën e këshillit zgjedhor, Këshilli Zgjedhor ka të drejtë që atë person ta largojë nga vendvotimi. Nëse personi nuk e lëshon vullnetarisht vendvotimin, këshilli zgjedhor e thërret policinë. Këshilli Zgjedhor, përjashtimin e secilit person nga vendvotimi, e shënon në Ditarin e evidencës së ngjarjeve.



II.3. VOTIMI

Votimi fillon në ora 07:00 dhe zgjatë pandërprerë deri në ora 19:00.

ÇKA BËHET NËSE VOTIMI FILLON MË VONË SE ORA 07:00?

Nëse

Atëherë:

Votimi ka filluar para orës 08:00		Votimi nuk vazhdohet; përfundon në ora 19
Votimi ka filluar në mes orës 08:00 dhe 10:00		Votimi vazhdohet për aq kohë sa ka zgjatur ndërprerja e votimit.
Votimi nuk ka filluar deri në ora 10:00		Njoftohet Komisioni Komunal i Zgjedhjeve; Votimi nuk fillon në atë ditë .

A MUND KËSHILLI ZGJEDHOR TA MBYLL VENVOTIMIN PARA ORËS 19:00?

Mundet nëse kanë votuar gjithë zgjedhësit e regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore.

Nëse kjo ndodhë, Këshilli Zgjedhor e mbyll vendvotimin dhe mbetet në vendvotim deri ora 19:00, ku fillon me numërimin e votave. Fton përfaqësuesit e autorizuar dhe vëzhguesit e akredituar.

Këshilli zgjedhor në asnjë mënyrë nuk guxon të ta lëshojë vendvotimin as të fillojë me numërimin e votave para orës 19:00!

KUSH KA TË DREJTË TË VOTOJË?

Çdo person i cili:

- është i regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore dhe
- posedon dokument valid biometrik për identifikim personal- letërnjoftim ose pasaportë.

CILI PERSON NUK MUND TË VOTOJË?

Nuk mund të votojë personi cili::

- nuk gjendet në listën zgjedhore;
- nuk posedon dokument përkatës të identifikimit;
- në gishtin e madh të djathtë ka gjurmë të ngjyrës së dukshme për markim të votuesve;
- refuzon të nënshkruhet në listën zgjedhore;
- nuk lejon të gjurmohet me gjurmë të dukshme për markim të votuesve;



SI VEPRON KËSHILLI ZGJEDHOR ME VOTUESIT TË CILËT NUK KANË MUNDËSI QË TË HYJNË NË VENDVOTIM?

Personat-zgjedhësit me nevoja të veçanta, të cilët të drejtën e tyre zgjedhore nuk kanë mundësi ta realizojnë në vendvotim, Këshilli Zgjedhor është i detyruar që atyre t'u mundësojë hyrjen në mënyrë përkatëse për realizimin e drejtës së tyre zgjedhore.

Nëse këta persona nuk sjellin me vete person i cili do t'u ndihmojë gjatë hyrjes në vendvotim, Këshilli Zgjedhor është i detyruar që të përcaktojë persona nga radhët e zgjedhësve të cilët janë hasur në atë moment, për t'i ndihmuar personit me nevoja të veçanta në realizimin e të drejtës së tij zgjedhore.

SI I MBLEDH TË DHËNAT E DALJES SË VOTUESVE KËSHILLI ZGJEDHOR?

Komisioni Komunal I Zgjedhjeve, të dhënat për daljen e votuesve i dorëzon në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, dhe ato shpallen. Zakonisht kjo bëhet tri herë gjatë ditës:

- në ora 10:00 ,
- në ora 13:00 dhe
- në ora 17:00.

Kryetari i KZ-së drejtpërsëdrejti para orës së përcaktuar:

- Duhet të ketë të përgatitur evidencën se sa votues kanë votuar në vendvotim.
- Anëtar i këshillit zgjedhor i cili shërben me ekstraktin e Listës zgjedhore, do t'i numëroj nënshkrimet dhe gjurmët e gishtërinjve ;
- Do të pranojë thirrje telefonike nga Komisionin Komunal i Zgjedhjeve;
- Komisionit komunal të zgjedhjeve, do ti jep të dhënat për daljen e votuesve.


II.3.1 PROCEDURA E VOTIMIT

Votimi kryhet personalisht ashtu që zgjedhësit shkojnë në vendvotim dhe një nga një votojnë. Anëtar i Këshillit Zgjedhor, i cili kujdeset për rendin në vendvotim dhe i kontrollon votuesit se a kanë gjurmë nga ngjyra e dukshme për markim të votuesve, gjatë gjithë kohës deri sa zgjat votimi:

- Rri ulur, sipas nevojës qëndron më afër hyrjes së vendvotimit.
- Organizon dhe kontrollon hyrjen dhe lëvizjen e votuesve në vendvotim.
 - Kujdeset të mos krijohet rrëmujë në vendvotim.
 - Nëse është e nevojshme mban rendin e votuesve të cilët presin në radhë para vendvotimit.
- Zgjedhësit të cilët kanë votuar i drejton kah dalja e vendvotimit.



Procesin e votimit mund ta ndajmë në disa faza, të treguara me fotot e shfaqura, në këtë renditje:



1. Kontrolli i votuesit a ka gjurmë nga ngjyra e dukshme për markim të votuesve
2. Kontrolli i dokumenteve për identifikim personal
3. Kontrolli dhe nënshkrimi në Ekstraktin e listës zgjedhore
4. Dhënie e fletëvotimit
5. Markimi i gishtit të madh të dorës së djathtë të votuesit, me ngjyrë të dukshme për markim të votuesve
6. Votimi pas paravanëve për votim.

HAPI 1: KONTROLLIMI I VOTUESIT

	Anëtari i këshillit zgjedhorë i kontrollon votuesit a kanë gjurmë nga ngjyra e dukshme për markim të votuesve	
Zgjedhësi me gjurmë nga ngjyra e dukshme për markim të votuesve në gishtin e madh të dorës së djathtë	----->	I drejtohet që ta lëshojë vendvotimin.
Zgjedhës i cili refuzon ti kontrollohet gishti i madh i dorës së djathtë	----->	I drejtohet që ta lëshojë vendvotimin.
Zgjedhës pa ngjyrë të dukshme për markim të votuesve në gishtin e madh të dorës së djathtë	----->	E drejton kah anëtari i këshillit zgjedhor i cili i kontrollon dokumentet e identifikimit.



HAPI 2: KONTROLLIMI I DOKUMENTEVE TË IDENTIFIKIMIT PERSONAL

	Anëtari i Këshillit Zgjedhor cili i kontrollon dokumentet e identifikimit personal: • Në bazë të dokumenteve të identifikimit personal të zgjedhësit verifikon identitetin e tij. Zgjedhësit mund ta tregojnë identitetin e tyre personal me njërin nga këto dy dokumente: 1) LETËRNJOFTIM BIOMETRIK VALID, ose 2) PASAPORTË BIOMETRIKE VALIDE lëshuar nga organi kompetent i Republikës së Maqedonisë	
	VENIRE1:PËRIDENTIFIKIMINEIDENTITETITËZGJEDHËSIT NUK MUND TË PRANOHET ASNJË DOKUMENT TJETËR (patentëshoferi, librezë shëndetësie, librezë të nxënësve ose indeks dhe etj.)	
	VENI RE 2: Votuesi i cili do të hyjë në vendvotim gjatë verifikimit të identitetit para Këshillit Zgjedhor është i detyruar të prezantohet si në mënyrën e paraqitur në fotografinë e dokumenteve të identifikimi!!!	
	SHUMË ME RËNDËSI: Përfaqësuesit e parashtruesve të listave dhe vëzhguesit e akredituar munden drejtpërdrejtë nga afër ta ndjekin verifikimin e identitetit të zgjedhësit!	
Zgjedhësi pa dokument përkatës	----->	Nuk guxon të votojë. E udhëzon që të sjellë dokument përkatës.
Zgjedhës me dokument përkatës	----->	E drejton kah kryetari i KZ,i cili shërben me ekstraktin e Listës zgjedhore.



HAPI 3: KONTROLLIMI DHE NËNSHKRIMI NË LISTËN ZGJEDHORE



Anëtari i KZ, i cili shërben me ekstraktin e listës zgjedhore:

- Kontrollon zgjedhësin se a gjendet ne ekstraktin e listës zgjedhore.
- Zgjedhësi i cili nuk gjendet në ekstraktin e listës zgjedhore e drejton:
 - në selinë e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve,
 - në Njësinë rajonale të KSHZ-së;
 - ta vizitojë veb faqen: <http://izbirackispisok.gov.mk/izspisok/>, për të kontrolluar a është i regjistruar në listën zgjedhore, nëse është i regjistruar në cilin vendvotim mund të votojë.
- Kur të verifikohet se zgjedhësi gjendet në ekstraktin e listës zgjedhore:
 - Në ekstraktin e Listës zgjedhore para emrit të zgjedhësit e rrethon numrin rendor.
 - Zgjedhësit i lejon të nënshkruhet në listën zgjedhore në grafën pranë emrit të tij.

Nëse zgjedhësi, i cili gjendet në Listën zgjedhore është analfabet ose ka të meta fizike, shtypë gjurmë e gishtit të madh të dorës së djathtë në grafën e rezervuar për nënshkrim. Për këtë rast përdoret mbështetës grafiti për gjurmë. Në rast se zgjedhësi nuk ka gisht të madh në dorën e djathtë, gjurmët do të shtypen në gishtin e e madh të dorës së majtë. Në rast se zgjedhësi nuk as gisht të madh në dorën djathtë as në dorën e majtë, nuk i merren gjurmët. Ky rast evidentohet në Ditarin e evidencës së ngjarjeve.

- Zgjedhësin e drejton kah anëtari i cili i jep fletëvotimet.
- E mban dokumentin e identifikimit personal derisa zgjedhësi të mbaroj me votimin.
- Dokumentin e identifikimit zgjedhësit ia kthen pasi zgjedhësi e lëshon fletëvotimin në kuti të votimit.



Zgjedhësi i cili nuk gjendet në ekstraktin e Listës zgjedhore	----->	E drejton në Komisionin komunal të zgjedhjeve, në Njësine përkatëse rajonale të KSHZ-së; E drejton ta vizitojë ueb faqen: http://izbirackispisok.gov.mk/izspisok/
Zgjedhësi i cili refuzon të nënshkruhet në Listën zgjedhore	----->	Nuk guxon të votojë. E urdhëron që ta lëshojë vendvotimin.
Zgjedhës i cili gjendet në ekstraktin e Listës zgjedhore	----->	Nënshkruhet në Ekstraktin e listës zgjedhore; E drejton kah anëtari që i jep fletëvotimet.

HAPI 4: DHËNJA E FLETVOTIMEVE



Anëtari i këshillit zgjedhor i cili jep fletëvotimet:

- Është përgjegjës për blloqet amë(koçanët) me fletëvotime.
- Kontrollon, numëron, dhe informon kryetarin e këshillit zgjedhor në rast se has në dëmtim ose gabim teknik në blloqet amë.
- Nga blloqet amë shpërndan një fletëvotim për një votues

KENI KUJDES : Numri serik mbetet në bllokun amë!!!

- E vulos fletëvotimin në vendin përkatës në anën e përparme me numrin e vendvotimit.
- Votuesit i jep fletëvotim.
- Votuesit ia shpjegon teknikën e votimit.



	Anëtari i Këshillit Zgjedhor i cili i jep fletëvotimet votuesit i shpjegon: • „Votohet prapa paravanit të votimit, me rrethimin e numrit rendor me stilolaps me ngjyrë të kaltër para parashtruesit të Listës së kandidatëve për të cilën dëshironi të votoni. Pastaj, fletëvotimin e palosni në atë mënyrë që mos të shihet se për cilin keni votuar. • Nëse gaboni nuk mund të merrni fletëvotim tjetër. • Drejtohuni kah kutia e votimit dhe çdo fletëvotim lëshojeni në kuti përkatëse. • Merreni dokumentin e identifikimit personal. Lëshojeni vendvotimin.
--	--

HAPI 5: MARKIMI ME MARKER - NGJYRË TË DUKSHME PËR MARKIM TË VOTUESVE

	Anëtari i këshillit zgjedhor i cili shërben Markerin-ngjyrë të dukshme për markim të votuesve: • Para se zgjedhësi të niset kah paravani zgjedhor, në gishtin e madh të dorës së djathtë i vendos gjurmë nga ngjyra e dukshme për markim të votuesve. Nëse zgjedhësi nuk ka gishtin e madh në dorën djathtë, markimi bëhet në gishtin e madh të dorës së majtë. Nëse nuk ka as gisht të madh në dorën e majtë, nuk i merren gjurmët. Ky rast evidentohet në Ditarin e evidencës së ngjarjeve në vendvotim. • drejton votuesin për të votuar kah paravani zgjedhor.
--	--

Zgjedhësi i cili nuk lejon t'i gjurmohet gishti me ngjyrë të dukshme për markim të votuesve	----->	- o Nuk i lejohet të votojë. - o Anëtari i cili shërben me markerin-ngjyrë të dukshme për markim të votuesve, kërkon nga votuesi që ta kthejë fletëvotimin e pranuar. - o Nëse votuesi refuzon, thirret përfaqësuesi i autorizuar i policisë. - o Nëse personi është nënshkruar në ekstraktin e Listës zgjedhore, në vërejtje të ekstraktit pranë emrit të tij shënohet se ky person nuk ka votuar. - o Fletëvotimi i papërdorur, gjatë numërimit të rezultateve shpallet i pavlefshëm. - o Rastin bashkë me të dhënat e zgjedhësit, shënohen në Ditarin e evidencës së ngjarjeve.
--	------------------	---



HAPI 6: VOTIMI PRAPA PARAVANIEVE ZGJEDHORE



Anëtari i këshillit zgjedhor i cili shërben Markerin-ngjyrë të dukshme për markim të votuesve:

- Kujdeset që prapa paravanit zgjedhor të jetë një votues, përveç rastit kur votuesit i duhet ndihmë.
- Kontrollon paravanet zgjedhore që dikush mos ka lënë material propagandues ose ka shënuar emrin e ndonjërit nga parashtruesit e listës së kandidatëve. Nëse ka gjëra të këtilla i largon.
- Kontrollon paravanet zgjedhore për tu vërtetuar se ka stilolaps për të votuar.

SECILI VOTUES PAS PARAVANIT ZGJEDHOR VOTON VETËM!
NJË VOTUES = NJË VOTË!

*Maqedonia është një nga vendet e rralla në botë
ku akoma vërehet votimi familjar dhe grupor!
PENGOJE KËTË!*

HAPI 7: LËSHIMI I ÇDO FLETËVOTIMI NË KUTI TË VOTIMIT



Anëtari i këshillit zgjedhor i cili shërben Markerin-ngjyrë të dukshme për markim të votuesve:

- Kujdeset që secili votues të drejtohet kah kutia e votimit me fletëvotim të palosura
- Kontrollon që të vërtetohet se secili zgjedhës fletëvotimet e palosura i lëshon në kutinë përkatëse të votimit.

SHUMË ME RËNDËSI: Nuk guxon t'i lejohet zgjedhësit të largohet nga vendvotimi pa e lëshuar fletëvotimin në kuti të votimit!!!

Në rast se votuesi i cili ka pranuar fletëvotimin, refuzon ta lëshojë në kuti të votimit, menjëherë thirret të intervenojë policia!!!

- Pas mbarimit të votimit, votuesin e drejton kah kryetari i KZ i cili votuesit ja kthen dokumentin e identifikimit personal.

Zgjedhësi i cili refuzon të lëshojë fletëvotimin në kuti të votimit

----->

- Menjëherë thirret përfaqësuesi i autorizuar i policisë;
- Rast bashkë me të dhënat personale të zgjedhësit shënohen në Ditarin për evidencën e ngjarjeve.



II.3.2. KUNDËRSHTIMET PREJ VOTUESVE

Nëse ndonjëri nga zgjedhësit mendon se iu është cenuar e drejta personale zgjedhore dhe dëshiron të parashtojë kundërshtim, Këshilli Zgjedhor:

- Do ta drejtojë në Komisionin komunal të zgjedhjeve ose në ueb- faqen e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve (www.sec.mk) prej ku mund të nxjerrë formular për parashtrimin e kundërshtimit

II.3.3. VOTIMI I ZGJEDHËSVE TË CILËVE JU DUHET NDIHMË

1. CILI MUND TË VOTOJË ME NDIHMËN E PERSONIT TJETËR

- Zgjedhësi i cili ka të meta fizike ose është analfabet dhe për këtë nuk ka mundësi të votojë sipas mënyrës së përshkruar të Kodit zgjedhor, ka të drejtë që me vete të ftojë person i cili do ti ndihmojë gjatë votimit.

2. ÇKA NËSE ZGJEDHËSI NUK KA FTUAR PERSON I CILI DO TI NDIHMONTE?

- KZ-ja, do të përcaktoj person nga radhët e zgjedhësve në vendvotim. Në asnjë mënyrë ky person nuk guxon të jetë nga radhët e anëtarëve të këshillit zgjedhor, përfaqësuesve të autorizuar të listës së kandidatëve ose nga radhët e vëzhguesve.

3. A MUNDET NJË PERSON I NJEJTË TË JU NDIHMON TË GJITHË ZGJEDHËSVE QË IU DUHET NDIHMA?

- JO. Një person i njëjtë mund të ndihmojë vetëm dy zgjedhës të cilëve ju duhet ndihma!

4. SI VOTON ZGJEDHËSI TË CILIT I DUHET NDIHMA?

- Këshilli zgjedhor, personit i cili ndihmon para se të votojë e këshillon që ndihma e tij të mos ndikoj në vendimin e zgjedhësit.
- Zgjedhësi dhe personi i cili ndihmon bashkë drejtohen kah paravani për të votuar. (Edhe në këtë rast është e detyrueshme votimi të kryhet pas paravanit zgjedhor).
- Personi i cili ndihmon i lexon gjithë listat, e pyet votuesin për cilën listë dëshiron të votojë dhe ia tregon votuesit numrin rendor para listës së kandidatëve për të cilën votuesi dëshiron të votojë.
- Votuesi personalisht e rrethon numrin rendor/plotëson fletëvotimin!
- Personi i cili ndihmon në vend të votuesit e plotëson fletëvotimin vetëm në raste kur votuesi është i verbër ose është me të meta fizike.
- Votuesi personalisht e lëshon fletëvotimin në kuti të votimit!
- Personi i cili ndihmon mund ta lëshojë fletëvotimin në kuti, vetëm në rast se votuesi ka të meta fizike dhe nuk është në gjendje që ta lëshojë personalisht.


5. KU REGJISTROHET VOTIMI ME PËRDORIMIN E NDIHMËS?

- Këshilli zgjedhor, votimin e këtij lloji e shënon:
 - во Записникот (Образец број 16а), каде се забележува бројот на гласачи кои барале помош при гласањето, и
 - Дневникот за евиденција на настани, при што во Дневникот се внесуваат податоците од личната карта на лицето кое помага и на забелешката се потпишуваат сите членови на ИО.



II.3.4. MBYLLJA E VENDVOTIMIT

- Vendvotimi mbyllet në ora 19:00 .
- Zgjedhësve të cilët në ora 19:00 janë hasur në objektin ku votohet , këshilli zgjedhor do t'u mundësojë që të votojnë.
- Anëtari i këshillit zgjedhor, i cili kujdeset për rendin në vendvotim dhe i kontrollon votuesit se a kanë gjurmë nga ngjyra e dukshme për markim të votuesve, në ora 19:00 qëndron i fund të rendit të zgjedhësve të cilët janë hasur në objekt. Pas kësaj nuk lejon votues tjerë të hyjnë në radhë për të votuar.
- Kur dhe zgjedhësi i fundit do të votojë, në vendvotim mund të mbeten vetëm personat e autorizuar.



Personat e autorizuar të cilët mund të jenë të pranishëm pas mbylljes së vendvotimit:

- anëtarët e këshillit zgjedhor
- përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listës
- vëzhgues të akredituar
- kryetari, anëtarët, zëvendësanëtarët e Komisionit komunal të zgjedhjeve, dhe
- kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

- Kur edhe votuesi i fundit e lëshon vendvotimin, kryetari i KZ-së:
 - do ta mbyll vrimën e kutisë së votimit,
 - në Ditarin e evidencës së ngjarjeve, do ta shënojë kohën e përfundimit të votimit, si dhe emrat e personave të autorizuar që janë të pranishëm në vendvotim,
 - në Procesverbalin numër 16a, do ta shënojë kohën e përfundimit të votimit,
 - në Ditarin e evidencës së ngjarjeve, i shënon numrat e shiritave sigurues me të cilët është mbyllur kutia e votimit,
 - do t'i informojë personat e autorizuar të pranishëm në vendvotim, që nëse e lëshojnë vendvotimin, pasi të fillojë numërimi i votave nuk do t'u lejohet prapë të kthehen në vendvotim.



II.3.5. NDËRPRERJA E VOTIMIT

KZ-ja, mund ta ndërpret votimin në këto raste:

- Nëse prishet rendi në vendvotim, derisa të rivendoset,
- Në raste të fatkeqësive natyrore dhe rrethanave të tjera të jashtëzakonshme,
- Nëse ardhjen deri në vendvotim nuk e siguron policia, ndërsa për këtë ka pasur nevojë,
- Nëse policia është thirrur, ndërsa nuk iu është përgjigjur thirrjes.

Për çdo rast nëse ka pasur ndërprerje të votimit, shkaqet evidentohen në Procesverbal (Formulari numër 16).

Nëse:

Atëherë:

Votim është ndërprerë më pak se një orë	----->	Votimi mbaron në orën 19 dhe nuk vazhdohet;
Votimi është ndërprerë më shumë se një orë, e më pak se tre orë	----->	Votimi vazhdon pas orës 19 për aq kohë sa ka zgjatur ndërprerja
Votimi është ndërprerë më gjatë se tre orë	----->	Njoftohet Komisioni komunal i zgjedhjeve; Votimi për atë ditë ndërpritet dhe nuk vazhdohet.

II.4. SUMIMI DHE VERIFIKIMI I REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE TË VENDVOTIMIT

Këshilli zgjedhor, pas mbylljes së vendvotimit vepron në këtë mënyrë:

A) BARAZIMI I FLETËVOTIMVE

1) KZ, i numëron nënshkrimet dhe gjurmët e gishtërinjve të votuesve në ekstraktin e Listës zgjedhore. Në këtë mënyrë përcaktohet numri i përgjithshëm i zgjedhësve që kanë votuar. Ky numër shënohet në Procesverbal (Formulari numër 16a).

2) Numërohen fletëvotimet e papërdorura. Numri i tyre verifikohet në këtë mënyrë:

Numri serik i fletëvotimit të fundit të papërdorur	-	Numri serik i fletëvotimit të parë të papërdorur	+ 1 =	Fletëvotim të papërdorura
Shembull:				
35700	-	35500	+ 1 =	201

Ky numër shënohet në Procesverbal (Formulari numër 16a).



3) Numri i fletëvotimeve të shfrytëzuara (të përdorura) në procesin e votimit nxirret me këtë formulë:

Numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pranuar	-	Numri i fletëvotimeve të përdorura	=	Fletëvotime të shfrytëzuara (të përdorura)
<i>Shembull:</i>				
800	-	201	=	599

Numri i fletëvotimeve të përdorura PATJETËR duhet të jetë i barabartë me numrin e zgjedhësve të cilët kanë votuar.

Nëse këto numra nuk janë të barabartë, Këshilli zgjedhor duhet këtë rast ta shënojë në Procesverbal (Formulari numër 16a, rubrika „kontrollimi i dytë pas mbylljes së vendvotimit“) në Ditar dhe ta njoftoj Komisionin komunal të zgjedhjeve.

4) Fletëvotimeve të përdorura:

- iu shkëputet këndi i poshtëm i djathtë,
- vihen në zarf të posaçëm i cili mbyllet dhe vulozet,
- mbi zarfin ngjitet etiketë në të cilën shënohet numri i vendvotimit, numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të përdorura dhe numri serik i fletëvotimit të parë dhe të fundit.

B) HAPJA E KUTISË SË VOTIMIT

Para hapjes së kutisë së votimit Kryetari i KZ-së::

- Pyet përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listës dhe anëtarët e KZ-së, a kanë vërejtje në lidhje me procedurën e votimit, në qoftë se ka, atëherë vërejtjet i shënon në Procesverbal (Formulari numër 16a), në pjesën për vërejtje për procedurën e votimit.
- kontrollon a janë të njëjtë numrat e shiritave sigurues plastik, me të cilët është mbyllur kutia e votimit gjatë hapjes së vendvotimit që janë të shënuar në Ditar.
- nëse numrat e shiritave përputhen, këtë e shënon në Ditar dhe vazhdon me hapjen e kutisë.
- Nëse numrat e shiritave nuk përputhen, këtë rast e shënon në Procesverbal (Formulari numër 16a), dhe për këtë rast e njofton KOMISIONIN KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE dhe vazhdon me procedurën e sumimit dhe konfirmimit të rezultateve.

C) NUMËRIMI I VOTAVE


- 1) Para se të hapet kutia e votimit, me short caktohet një nga anëtarët e Komisionit Zgjedhor cili:
 - Fletëvotimet një nga një do t'i nxjerrë nga kutia e votimit
 - Fletëvotimet e hapura ia dorëzon kryetarit të Këshillit zgjedhor.
- 2) Kryetari i Këshillit Zgjedhor, të gjithë të pranishmëve ua tregon fletëvotimin.



- 3) KZ-ja, përcakton se fletëvotimi a është i vlefshëm, i paplotësuar ose i pavlefshëm dhe për cilën të kandidatit është votuar. Për këtë qëllim në tryezën e punës formohen grumbuj përkatës të fletëvotimeve.



Fletëvotim i paplotësuar



Fletëvotim i pavlefshëm



Fletëvotimi i vlefshëm:

Fletëvotimi është i vlefshëm nëse është në pajtim me nenin 110 të Kodit zgjedhor: „Zgjedhësi votimin e kryen në atë mënyrë që e rrethon numrin rendor të parashtruesit të listës, përkatësisht numrin rendor para kandidatit për të cilin është përcaktuar të votojë dhe fletëvotimin e palosur e lëshon në kuti të votimit.”

Për fletëvotim të vlefshëm llogaritet edhe ai fletëvotim i cili në mënyrë të sigurt dhe pa hamendje mund të konstatohet për cilën listë të kandidatëve ka votuar zgjedhësi.

Gjatë verifikimit çka nënkupton „mënyrë të sigurt dhe pa hamendje„?. Duhet nisur nga ajo se si është plotësuar fletëvotimi, përkatësisht nëse zgjedhësi në mënyrë të qartë ka shprehur dëshirën, ka votuar vetëm për një kandidat.

Mënyrë e sigurt dhe pa hamendje e shprehjes së dëshirës të zgjedhësit mund të paraqesë edhe fletëvotimi në të cilën zgjedhësi në vend të numrit rendor para parashtruesit të listës, ka rrethuar emrin dhe mbiemrin e kandidatit ose simbolin e parashtruesit të listës ose në një mënyrë tjetër përkatëse është përcaktuar për parashtruesin e listës, nëse shënimi është në suazat e një liste të kandidatit.

Fletëvotimi është i pavlefshëm:


- nëse ka të rrethuara më shumë lista të kandidatit
- nëse është e shlyer pjesërisht ose tërësisht,
- nëse vula në fletëvotim nuk është përkatëse me numrin e vendvotim ku është votuar
- nëse në anën e përparme nuk ka vulë
- nëse është e rrethuar, përkatësisht e plotësuar me flomaster me çfarëdo ngjyre
- nëse është e rrethuar, përkatësisht e plotësuar me stilolaps me çfarëdo ngjyre, përveç ngjyrë të kaltër
- nëse është i paplotësuar

4) Fletëvotimi vhihet në grumbull përkatës, të kthyer me fytyrë përpjetë.

5) Procedura përsëritet derisa të gjitha fletëvotimet të nxirren nga kutia e votimit.

6) KZ-ja, gjithë fletëvotimet e PA PLOTËSUARA:

- I shlyen në tërë gjatësinë, dhe
- I vendosë në grumbull me fletëvotimet e pavlefshme.





7) të gjitha fletëvotimet e PAVLEFSHME vihen në zarf të posaçëm në të cilin shkruhet „fletëvotime të pavlefshme”.

Nëse ndonjëri nga përfaqësuesit e autorizuar ose anëtar i këshillit zgjedhor gojarisht kundërshton për ndonjë fletëvotim të pavlefshëm, këshilli zgjedhor vendosë me anë të votimit dhe rasti shënohet në Procesverbal (Formulari numër 16a).

VERIFIKIMI I VOTAVE TË FITUARA SIPAS LISTËS SË KANDIDATIT

- fletëvotimet nxirren një nga një dhe konstatohet për cilën listë është votuar
- vota e dhënë regjistrohet në letër të thjeshtë
- fletëvotimet e secili grumbull edhe një herë numërohen
- rezultatet shënohen në Procesverbal (Formular numër 16a).

KENI KUJDES NË SIGURINË E FLETËVOTIMEVE TË NUMËRUARA!

D) PLOTËSIMI I PROCESVERBALIT

KZ-ja përpilon procesverbalin e votimit, sumimit dhe verifikimit të rezultateve në Procesverbalin e veçantë:

- Formulari numër 16a, për zgjedhjen e Kryetarit të Republikës së Maqedonisë.

Këtë formularë e pranoni bashkë me materialin e besueshëm zgjedhor të përcaktuar dhe të vulosur me vulë të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve. Formularët bashkë me udhëzimet e plotësimeve të tyre mund ti gjeni në internet faqen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve www.sec.mk. PARA SE TË FILLONI ME PLOTËSIMIN E PROCESVERBALIT LEXONI ME KUJDES UDHËZIMET.

KZ-ja, pranon VETËM NJË EKZEMPLAR të formularit origjinal numër 16a me vulë të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve. T'i ruani me kujdes!

Procesverbalin:

- e plotëson kryetari i KZ-së,
- e nënshkruajnë gjithë anëtarët e KZ-së
- i dorëzohet personalisht kryetarit të KOMISIONIT KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE.

Për plotësimin e procesverbalit:

Këshilli zgjedhor në raste të GABIMEVE GJATË PLOTËSIMIT TË PROCESVERBALIT:

- 1) me stilolaps e shlyen fjalën, përkatësisht numrin e gabuar, që edhe më tej të mbetet i lexueshëm,
- 2) me stilolaps plotëson të dhënë e saktë,
- 3) përsëri përmirësimi nënshkruhet kryetari i KZ-së dhe vihet vula e këshillit zgjedhor.

Shembull:

~~55~~

Numri i gabuar

57

E dhëna e saktë



Vula dhe nënshkrimi i kryetarit të këshillit zgjedhor



E) KËSHILLI ZGJEDHOR PAS NËNSHKRIMIT TË PROCESVERBALIT NUMËR 16a:




- Plotëson dhe nënshkruan kopjet e karbonizuara të Formularit numër 16.
- Secilit parashtues të listës së kandidatëve dhe vëzhgues të akredituar që është i pranishëm në vendvotim, i jepet një kopje të procesverbalit (Formulari numër 16a).
- Plotëson Procesverbalin për dorëzimin e materialit zgjedhor (Formulari numër 20a).
- Në vend të dukshëm të objektit ku është i vendosur vendvotimi ngjet një nga kopjet e karbonizuara të Formularit numër 16a.

VENI RE: Kopja vendoset në vendin ku pas mbylljes së vendvotimit qytetarët e interesuar që të mundën të informohen për rezultatet zgjedhore, do të thotë vendosen në derën hyrëse të shkollës ose objektit. Me rëndësi është që të garantohet transparenca e procesit zgjedhor që është si udhërrëfyes për njohjen dhe ndjekjen e procedurave zgjedhore.

II.5. PAKETIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR

Në thes plastik të tejdukshëm për transportimin e materiali zgjedhor të besueshëm, në të cilin vihet etiketë ngjithëse me emrin e komunës, lloji i zgjedhjeve dhe numri i vendvotimit, pakëtohen:


- 1.1. Zarfi i mbyllur ku më parë janë të vendosura fletëvotimet e përdorura (të vlefshme dhe të pavlefshme);
- 1.2. Zarfi i mbyllur me fletëvotime të papërdorura dhe blloku amë (koçani) me fletëvotime të përdorura;
- 1.3. Zarfi i mbyllur me ekstraktin e Listës zgjedhore dhe ditarin e evidencës së ngjarjeve

		
Fletëvotime të përdorura	Fletëvotime të papërdorura	Lista zgjedhore
	+	+
	Blloku amë (koçani) me fletëvotime të përdorura	Ditari i evidencës së ngjarjeve






- 1) Në thesin plastik të tejdukshëm në të cilin nuk ka etiketë ngjitëse pakëtohet materiali jo i besueshëm zgjedhor.



- 2) PROCESVERBALI ORIGJINAL për sumimin e rezultateve (Formulari numër 16a) dhe Procesverbalin për dorëzimin e materialit zgjedhor (Formulari numër 20a) me një zarf të posaçëm dorëzohen në Komisionin komunal të zgjedhjeve, i dorëzohen personalisht kryetarit të Komisionit komunal të zgjedhjeve.





3) Markerët-ngjyrë e dukshme për markim të votuesve dhe vula me numër të vendvotimit i jepen në dorë personit të autorizuar të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve.

4) Gjithashtu, kutitë e votimit dorëzohen në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve.

Materialin zgjedhor, në Komisionin komunal të zgjedhjeve e dorëzon kryetari i KZ-së në përcjellje të anëtarëve të këshillit zgjedhor dhe përfaqësuesve të autorizuar të listave (nëse këta shfaqin dëshirë që të jenë të pranishëm në dorëzimin e materialit në Komisionin komunal të zgjedhjeve).

Këshillin zgjedhor, gjatë transportimit të materialit zgjedhor në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve, e siguron policia, në rast se kërkon këshilli zgjedhor.

**TË GJITHË KËSHILLAT ZGJEDHOR MATERIALIN E DORËZOJNË
NË KOMISIONIN KOMUNAL KOMPETENT TË ZGJEDHJEVE!**



III. NDALESAT NË VENDVOTIM

III.1. NDALIMI I PËDORIMIT TË TELEFONIT CELULAR DHE FOTOAPARATIT PËR FOTOGRAFIMIN E FLETËVOTIMIT



Ndalohet përdorimi i telefonit celular ose fotoaparatit për fotografimin e fletëvotimit. Përfaqësuesit e autorizuar të listave, vëzhguesit dhe votuesit, në ditën e zgjedhjeve në vendvotim nuk guxojnë të përdorin telefon celular, fotoaparate dhe mjete tjera për fotografimin e fletëvotimit.

Këshilli Zgjedhor, ka të drejtë ta largojë secilin person nga vendvotimi nëse nuk i përmbahet këtij ndalimi.

III.2. NDALIM PËR MBAJTJEN E ARMËS NË VENDVOTIM

Përveç policisë, askush nuk guxon të vjen i armatosur në vendvotim. Policia në vendvotim, mund të hyjë vetëm në raste kur thirret nga këshilli zgjedhor dhe kur vërehet prishje e rendit dhe qetësisë.





III.3. NDALIMI I VOTIMIT FAMILJAR, GRUPOR DHE NË EMËR TË TJETRIT

E drejta e fshehtësisë së votës garantohej me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Këshillat zgjedhor, janë ata të cilët kanë përgjegjësi ti njohin dhe t'i pengojnë përpjekjet eventuale për cenimin e fshehtësisë së votimit

**KËSHILLI ZGJEDHOR GJATË KOHËS SË VOTIMIT VOTUESIT DUHET TI SIGUROJË
QË TË JETË VETËM PAS PARAVANIT ZGJEDHOR !**

Në Republikën e Maqedonisë, votimi familjar, grupor dhe në emër të tjetrit janë të ndaluar. Kjo paraqet cenim të drejtës zgjedhore, bazë për cenimin e fshehtësisë së votës dhe mund të çojë deri në prishjen e zgjedhjeve. Me votimin familjar cenohet fshehtësia e votës, barazia e drejtës zgjedhore dhe përcaktimi i lirë i votimit.

Ndalimi i votimit familjar, grupor dhe votimit në emër të tjetrit i përket:

- NDALIMIT një person të votojë për tjetrin/për tjerë(votimi në emër të tjetrit);
- NDALIMIT një anëtar i familjes anëtarëve tjerë pas paravanit zgjedhor t'u tregojë si dhe për cilin të votojnë (votim familjar);
- NDALIMI dy vetë, grup ose gjithë familja të votojnë pas paravanit zgjedhor (votim grupor) etj.



KZ-ja, është i detyruar të sigurojë që gjatë kohës së votimit votuesi të jetë vetëm pas paravanit zgjedhor!



Anëtarët e këshillit zgjedhor DUHET këto dukuri t'i hetojnë dhe t'i PENGJOJNË.

Anëtarët e këshillit zgjedhor, në raste të tentimit të votimit familjar janë të detyrueshëm:

1. Ta pengojnë tentimin dhe
2. Çdo tentim ta evidentojnë në Ditarin e evidencës së ngjarjeve

Kundër anëtarit të Këshillit Zgjedhor i cili ka mundësuar (nuk ka penguar) votim familjar do të ngrihet:

- procedurë disiplinore (sanksion-ndërprerje marrëdhënie pune)
- padi kundërvajtje (sanksion-gjobë prej 500 deri 1.500 EUR)
- padi penale (sanksion – dënim me burg së paku 5 vjet)

Kundër personit i cili merr pjesë në votim familjar:

- të parashtrohet padi kundërvajtje
- të parashtrohet padi penale

Kodi zgjedhor, votimin familjar e parasheh si bazë për prishjen e votimit në vendvotim

III.4. BASHKËPUNIMI ME POLICINË NË DITËN E ZGJEDHJEVE

Këshilli zgjedhor kujdeset për mbajtjen rendit dhe qetësisë në vendvotim. Këshilli Zgjedhor mund të kërkojë ndihmë prej policisë për rivendosjen e rendit në vendvotim.

Policia, siguron rendin në vendvotim, objektin ku gjendet vendvotimi dhe kalimin deri në vendvotim (lokalin ku votohet).

Policia siguron vendvotimin pandërprerë nga ora 6,00 deri në ora 19,00, përkatësisht deri në përfundimin e votimit. Policia pas përfundimit të votimit siguron transportin e materialit zgjedhor deri në KOMISIONIN KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE.

Nëse kërkohet intervenim i policisë në vendvotim, rasti konfirmohet dhe shënohet në Formular i cili është pjesë përbërëse i këtij Doracaku!

Policia mund të vjen në vendvotim vetëm nëse është e thirrur nga :

- kryetari ose zëvendëskryetari i KZ-së,
- në mungesë të kryetarit ose zëvendëskryetarit, thirrjen e policisë mund ta bëjë anëtar i KZ-së.

Thirrja e policisë mund të bëhet me gojë, me shkrim, telefon ose në mënyrë tjetër më të volitshme. Për çdo intervenim të policisë njoftohet Komisioni komunal i zgjedhjeve dhe plotësohet formular përkatës për konfirmimin e nevojës të thirrjes së policisë.

Këshilli zgjedhor mund të thërras policinë për intervenim në lokalin ku votohet për shkak të:

- prishjes së rendit në vendvotim- deri të bëhet rivendosja e tij.
- largimin e personave të paautorizuar që janë të pranishëm në lokalin e votimit.
- Në përjashtim, largimin e kryetarit, zëvendëskryetarit ose anëtarit të këshillit zgjedhor cili prish rendin dhe qetësinë në vendvotim.



- Largimin e gjithë personave të paautorizuar nga objekti pas përfundimit të votimit, për të siguruar numërim dhe sumim të papenguar të rezultateve.

Në rast se kërkohet nga ana e KZ-së, policia e siguron këshillin zgjedhor deri në dorëzimin e procesverbaleve dhe materialit zgjedhor deri në KOMISIONIN KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE.

Nëse policia nuk i përgjigjet kërkesës së Këshillit Zgjedhor, ku nevoja e thirrjes së saj ka ndikuar në zbatimin e votimit, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, sipas detyrës zyrtare ose kundërshtimit të parashtruar, me AKTVENDIM E ASGJËSON VOTIMIN në këtë vendvotim.

